

SKEDË INFORMATIVE MBI DOKUMENTACIONIN PËR PENSION INVALIDITETI

Kushtet për të përfituar një pension invaliditeti, sipas sipas neneve 35, 36, 37, 37/1, 38, 39, 44, 45, 48, 49, të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në RSH", të ndryshuar, është:

1. Periudha e sigurimit.

Ndërsa dokumentacioni i detyrueshëm për të përfituar pension invaliditeti, është si më poshtë:

Nr.	EMËRTIMI I DOKUMENTACIONIT TË DETYRUESHËM	INSTITUCIONI QË LËSHON DOKUMENTIN
1.	Fotokopje e Kartës së identitetit;	Vetë personi
2.	Certifikatë familjare;	Zyra e Gjendjes Civile
3.	Certifikatë martese (e detyrueshme vetëm për femrat);	Zyra e Gjendjes Civile
4.	Librezë pune;	Qendra e Punës
5.	Librezë kontributesh;	Qendra e Punës
6.	Vërtetim për periudhën e Shërbimit të Detyrueshëm Ushtarak, për meshkujt;	Qendra e Personel Rekrutimit
7.	Fletë drejtimi për KMCAP;	Institucioni mjekësor i autorizuar
8.	Fletë dalje Spitali;	Institucioni mjekësor i autorizuar
9.	Ekzaminime të veçanta;	Institucioni mjekësor i autorizuar
10.	Analiza mjekësore.	Institucioni mjekësor i autorizuar
11.	Vërtetim për pagesën e paaftësisë së përkohshme.	Qendra e Punës

Dokumentacioni shtesë në rastet e mungesës së Librezës së punës dhe asaj të Kontributeve:

1.	Deklaratë për vitet e punës;	Vetë personi
2.	Vërtetim nga Qendra e punës për periudhat e punës;	Qendra e Punës
3.	Vërtetim page, sipas së cilës është derdhur kontribut që nga viti 1994 deri në momentin e lënies së punës;	Qendra e Punës
4.	Vërtetim i pagesës së papunësisë (asistencë);	Zyra e Punës
5.	Vendim gjykate për njohje vjetërsie në punë;	Gjykata
6.	Mandat-pagesat për derdhjen e kontributeve;	Vetë personi
7.	Vërtetim për Pagesën kalimtare (si ushtarak).	Qendra e Punës

Dokumentat shtesë në rastet e përfitimit si ish - i dënuar politik:

1.	Vërtetim për faktin e dënimit për motive politike dhe kohën e vuajtjes së tij;	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
2.	Vërtetim i gjendjes gjyqësore.	Zyra e Gjendjes Gjyqësore

Dokumentacioni shtesë në rastet e ndryshimit të gjeneralitetit:

1.	Vërtetim nga Njësia Administrative/Bashkia për ndryshimin e gjeneralitetit;	Zyra e Gjendjes Civile
2.	Vërtetim nga qendra e fundit e punës për ndryshimet e gjeneralitetit.	Qendra e Punës

Dokumentacioni shtesë në rastet kur personi ka punuar si kuadër në ish-kooperativë bujqësore:

1.	Vendimi i emërimit në punë, si kuadër;	Arkiva e Shtetit
2.	Diploma e shkollës së mesme/lartë.	Drejtoria Arsimore/Shkolla e Lartë

Dokumentacioni shtesë për rastet e përfitimit nga aksidenti në punë/sëmundjet profesionale:		
1.	Proces- Verbal i Aksidentit në Punë;	Qendra e Punës dhe Inspektorati Shtetëror i Punës
2.	Vërtetim nga Prokuroria (për fillim procedimi penal në rast të një aksidenti në punë për shkak të detyrës).	Prokuroria e Rrethit/Prokuroria e Krimeve të Rënda

Dokumentacioni shtesë për përfitimin e pensionit të pjeshëm		
1.	Vërtetim për llojin e punës së kryer.	Qendra e Punës

Dokumentacioni shtesë për kompensimin e energjisë elektrike:		
1.	Vërtetim për pagesën e energjisë elektrike;	OSSH
2.	Deklaratë për kompensimin e energjisë.	Vetë personi, sipas formatit të ALSSH-së

Për të përfituar një pension suplementar shtetëror, konform nenit 14, të Ligjit nr. 8097, datë 21.03.1996, i ndryshuar, duhet paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:		
1.	Fotokopje e Kartës së Identitetit;	Vetë personi
2.	Certifikatë familjare;	Zyra e Gjendjes Civile
3.	Vërtetim i vjetërsisë në shërbim/detyrë/funksion;	Qendra e Punës
4.	Vërtetim i pagës referuese të detyrës/funksionit;	Qendra e Punës
5.	Fotokopje e Librezës së punës;	ALSSH
6.	Dëshmi penaliteti/Vërtetim i gjendjes gjyqësore.	Zyra e Gjendjes Gjyqësore

Dokumenta shtesë për pension suplementar si ish-ushtarak, konform neneve 17, 18, të Ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009, i ndryshuar:		
1.	Fotokopje e Kartës së Identitetit;	Vetë personi
2.	Certifikatë familjare.	Zyra e Gjendjes Civile